

L I G J
Nr.7977, datë 26.7.1995

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 “PËR KODIN E PROCEDURËS
PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491 datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,
me propozimin e Komisionit të Ligjeve,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në nenin 525, shtohet paragrafi i
dytë me këtë përmbajtje:

“Për çështjet penale që ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi ndodhen në fazën e hetimit ose të
gjyqimit në shkallë të parë dhe në apel, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të
mëparshëm, por jo më pas se 15 nëntor 1995”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1 gusht 1995, së bashku me Kodin e Procedurës Penale të Republikës
së Shqipërisë.

**Shpallur me dekretin nr.1172, datë 3.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali
Berisha**